



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMLORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS SKENDERAJ

Numri i lëndës: 2024:024784

Datë: 21.03.2024

Numri i dokumentit: 05486709

C.nr.678/2023

GJYKATA THEMLORE MITROVICË – DEGA NË SKENDERAJ, Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Hajrullah Aruqi me bashkëpunëtoren profesionale Sandra Fazliu, në çështjen juridike kontestimore të paditësve E.X., F.Sh., F.S., F.F. dhe F.M., të cilet i përfaqëson Q.R. avokat në Skenderaj, kundër të paditurës Komuna Skenderaj – Drejtoria Komunale e Arsimit, të cilën e përfaqëson përfaqësuesi ligjor E.Ç., mbi bazën e inflacionit, duke vendosur sipas marrëveshjes se palëve të arritur nga ndërmjetësuesja A.Sh.S., ndërmjetësues i licencuar, bazuar në nenin 15 paragrafi 1 të Ligjit nr.06/L-009 për Ndërmjetësim dhe pas vlerësimit të marrëveshjes se palëve të arritur në ndërmjetësim, me dt.21.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

1. APROVOHET Marrëveshja Nr. ND.87/2024 e dt.06.02.2024 e arritur ne procedurën e ndërmjetësimit në lëndën C.nr.678/2023.
2. Marrëveshja e arritur ne ndërmjetësim e fiton fuqinë e vendimit të formës se prerë dhe dokumentit përmbarues sipas dispozitave ligjore në fuqi përfshirë këtu edhe dispozitat e Ligjit për Procedurën Përmbarimore.
3. Vendimi iu dorëzohet palëve dhe kundër të njëjtit, sikurse edhe kundër marrëveshjes se arritur, palët nuk kanë të drejtë ankese.
4. Prishjen apo anulimin e marrëveshjes se arritur në ndërmjetësim, palët kanë të drejtë ta kërkojnë vetëm me padi të veçantë në procedurë të veçantë gjyqësore.

Gjyqtari
Hajrullah Aruqi